



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	09.07.2026
REFERENC-Ë:	26/2779/MMPH
PËR/ZA/TO:	"SKY GROUP SGS" SH.P.K. Prishtinë Thërrmim dhe seperim i andeziteve në Greikoc, Suharekë
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 26/2779/MMPH, datë 19.05.2026, të parashtruar nga operatori "SKY GROUP SGS" SH.P.K. Prishtinë, për thërrmimin dhe seperimin e andeziteve në Greikoc, Suharekë.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore për operatorin "SKY GROUP SGS" SH.P.K. Prishtinë, për thërrmimin dhe seperimin e andeziteve në Greikoc, Suharekë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary*

Nr.: 26/2779/MMPHI
Datë: 09.07.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "SKY GROUP SGS" SH.P.K. Prishtinë, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 26/2779/MMPH, datë: 19.05.2026, për thërrmimin dhe seperimin e andeziteve në Greikoc, Komuna e Suharekës, në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 01009-0 dhe nr. 01010-1, numri i lëndës së certifikatës 5390/2019, ZK. Samadrexhë, Komuna e Suharekës.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore me nr. prot. 26/2779/MMPH, datë: 19.05.2026, të operatorit "SKY GROUP SGS" SH.P.K. Prishtinë, për thërrmimin dhe seperimin e andeziteve në Greikoc, Komuna e Suharekës, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën administrativisht dhe në përputhje me nenin 10

paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 26.05.2026 si në vijim:

- Leja për aktivitete të veçanta nga KPMM për seperim të andeziteve.

Operatori ka sjellur informata shtesë me datë 29.05.2026 si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta nga KPMM me nr. 796/KPMM/2020, me nr. prot. 2671, dt. 24.07.2020 dhe afat të vlefshmërisë deri më 23.07.2025 (me afat të skaduar).

Operatori nuk ka sjellur dëshmi ne përputhje me kërkesën e komisionit të dt. 26.05.2026.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur me datë 01.07.2026, konstatoi se operatori N.P.T. "SKY GROUP SGS" SH.P.K. Prishtinë, për thërrmimin dhe seperimin e andeziteve në Greikoc, Komuna e Suharekës nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.



U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Suharekës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.